



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°01/2022

Hagë, 13/01/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme. Gjithashtu, kjo është një mundësi që gazetarët t'i drejtojnë pyetje që mund të kenë zëdhënësit të Gjykatës.

Pas pushimit dimëror të gjykatës, informimet javore rifillojnë të enjteve në orën 14:30.

Këtë javë, një prej të akuzuarve që mbahet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, z. Kadri Veseli, udhëtoi drejt Kosovës për një vizitë nën ruajtje. Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzoi Zyrën Administrative të organizonte këtë vizitë nën arrest drejt Kosovës për z. Veseli që të vajtojë me familjen, dhe që u lejua për arsye humanitare bindëse.

Gjatë vizitës, i akuzuari qëndroi në paraburgim dhe nën ruajtje nga Dhomat e Specializuara. EULEX-i dhe Policia e Kosovës mbështetën Dhomat e Specializuara të Kosovës gjatë vizitës.

Më 11 janar, z. Veseli u transferua sërish në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Po ashtu më 11 janar, rifilluan seancat për çështjen gjyqësore *Gucati dhe Haradinaj*.

Një nga gjykatësit u paraqit përmes video-lidhjes për shkak të kufizimeve prej Covid-19. Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave, gjykatësit e trupit gjykues duhet të jenë të pranishëm në të gjitha fazat e procesit dhe seancat nuk mund të mbahen në mungesë të një gjykatësi. Gjykatësi rezervë mund të zëvendësojë një gjykatës me





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°01/2022

Hagë, 13/01/2022

kohë të plotë vetëm në rastet kur ky i fundit përgjithnjë nuk mund të vijojë të marrë pjesë në një çështje gjyqësore, ndërron jetë ose jep dorëheqjen.

Seancat filluan me paraqitjen e provave prej Mbrojtjes së Haradinajt. Dëshmitari i parë ishte vetë z. Haradinaj. Në fillim të dëshmisë, trupi gjykues pranoi deklaratën e tij si provë. Deklarata lidhet me të shkuarën e tij, mendimin rreth DHSK-së dhe ZPS-së, interpretimin e tij të “interesit publik” dhe veprimet e sjelljen e tij sa u takon veprave penale për të cilat ngrihen akuzat. Më pas, z. Haradinaj iu parashtuan pyetje nga Mbrojtja e vet. Mbrojtja e z. Gucati nuk kishte pyetje për z. Haradinaj. Pyetjet nga ana e Prokurorisë filluan ditën e mërkurë dhe pritet të përfundojnë sot ose nesër.

Dëshmitari tjetër në çështjen gjyqësore *Gucati dhe Haradinaj* pritet të fillojë dëshminë nesër ose të hënën.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, konferenca përgatitore për ecurinë e çështjes është planifikuar të mbahet nesër pasdite, në të cilën palët do të diskutojnë aspekte që përfshijnë nxjerrjen e provave nga Prokuroria për Mbrojtjen dhe ecurinë e hetimeve nga palët.

Gjykimi i Salih Mustafës do të rinisë të martën, 18 janar, me dëshminë e dëshmitarit W04485, të thirrur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Ky dëshmitar pritet të dëshmojë me masa mbrojtëse, ku përfshihet ndryshimi i zërit dhe fytyrës.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

